OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1365/1
Data Datum Date 21.01.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë,08.01.2013
Nr. 0204.1365

**PËR:** Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut
Demë Çeta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË KOMUNËS SË ISTOGUT, NR. 54, 55, DHE 57/2012

të pranuar me datë,31.12.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të hollësishëm të Vendimeve Nr. 54, 55 dhe 57/2012 , të miratuara me datë 21.12.2012 nga Kuvendi i Komunës së Istogut, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara si vijon, kanë efekte të plotë juridike,

- Vendim për hapjen e diskutimit publik të Projekt-Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobat,
- Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2013,dhe
- Vendim për themelimin e Kshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Minister i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1365/1
Data Datum Date 21.01.2013

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum,08.01.2013
br. 0204.1365

**Za**: Haki Rugova, Gradonačelnik opštine Istok
Demë Çeta, Predsedavajući skupštine opštine Istok

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluka opštine Istok ,br. 54, 55, i 57/2012

Primljeno dana ,31.12.2012

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva , nakon detaljnijeg razmatranja odluka br. 54, 55 i 57/2012 , odobreno dana 21.12.2012 od strane Skupštine opštine Istok , **POTVRĐUJE zakonitost** ovih akata i procenjuje da isti ti akti su u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni aktovi sa potpunim pravnim dejstvom su kao što sledi,

- Odluka o otvaranju javne diskusije nacrt-uredbe o porezima,taksama i kaznama.
- Odluka o usvajanju plana rada Skupštine opštine za 2013 ,i
- Odluka o osnivanju opšptinskog saveta za bezbeednosti zajednica ,

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i ministar MALS-a,**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Direktorima odeljenja i kancelarija*
*Arhivi MALS-a.*

| Republika e Kosovës | KUVENDI I KOMUNËS | | Komuna e Istogut |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.54/2012 | Data: 21.12.2012 | |

Kuvendi i Komunës së Istogut, në pajtim me nenin 34.2. të Statutit të Komunës, 01Nr.55/08, në mbledhjen e mbajtur me 21.12.2012, shqyrtoi Projekt- Rregulloren për të taksat, ngarkesat dhe gjobat dhe mori këtë:

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 31.12.2012
Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera
-III- 204-1365-3

## VENDIM

I. Hapet diskutimi publik për Projekt- Rregulloren për të taksat, ngarkesat dhe gjobat.

II. Diskutimi publik për projekt-rregulloret e cekura më lartë, do të jetë i hapur prej 22.12.2012 deri më 07.01.2013.

III. Projekt-rregullorja është e ekspozuara në Sallën e Kuvendit të Komunës, në Istog, për çdo ditë pune prej orës $08^{00}$ deri në orën $16^{00}$.

IV. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, qe t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë projekt-rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.

V. Për çdo informatë të interesuarit mund t'i drejtohen Sekretarit të KK-së, zyra nr.4, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

VI. Ky Vendim të shpallet: në tabelën e shpalljeve, ne mjetet e informimit elektronik dhe ne Ueb faqen e Komunës së Istogut, me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës së Istogut.

Kryesuesi,
Demë Ceta

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

| Republika e Kosovës | KUVENDI I KOMUNËS | | Komuna e Istogut |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.57/2012 | Data: 21.12.2012 | |

Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 40. paragrafi 40.2. germa d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33. Pika 4) të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me 21.12.2012, shqyrtoi Planin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2013 dhe mori këtë:

# V E N D I M

I. Miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2013.

II. Plani i Punës është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës dhe një kopje në arkivin e Zyrës së këtij kuvendi.

K r y e s u e s i,
Demë Geta

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

| Republika e Kosovës | KUVENDI I KOMUNËS | | Komuna e Istogut |
|---|---|---|---|
| | 01 Nr.55/2012 | Data: 21.12.2012 | |

Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 40. paragrafi 40.2. germa e) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008), nenit 3. paragrafi 2. dhe nenit 4. të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MBP-së dhe 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur me 21.12.2012, shqyrtoi Listën e propozuar nga Kryetari i Komunës për anëtar të Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe mori këtë:

# VENDIM

I. Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në përbërje:

1. Haki Rugova, Kryetar i Komunës, Kryesues;
2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;
3. Muhamet Lipa, Bashkësia Islame;
4. Don Isak Dodës, Kisha Katolike,
5. Pop Jovica, Kisha Ortodokse,
6. Xhafet Blakaj, Komuniteti Shqiptar;
7. Përfaqësuesi i Komuniteti Serb;
8. Alil Sejdovic, Komuniteti Boshnjak;
9. Visar Krasniqi, Komuniteti Romë;
10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;
11. Fazli Stolli, nga Komitetit për Komunitete;
12. Sanije Mavraj, Zyrtare për barazi gjinore;
13. Agim Haxhiu, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;
14. Zizë Bujupaj, Kryesuese e këshillit të prindërve të arsimit në komunë;
15. Beqir Selmanaj, Kapiten i FSK;
16. Suada Feri, KLSP;
17. Blendinela Shatri, EVSB;
18. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;
19. Alma Destanovic, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;
20. Asdren Hasanaj, OJQ"LIRIA";
21. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";
22. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS";
23. Një përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit;
24. Daut Kabashi, Njësia e Pylltarisë.

II. KKSB do të funksionojë dhe realizojë përgjegjësit e tij në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MBP-së dhe 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

III. Mandati i Këshillit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të këtij Kuvendi.

IV. Të gjitha punët administrativo-teknike për nevoja të Këshillit do t'i kryejë Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe për zbatimin e tij ngarkohen: anëtarët e Këshillit dhe Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

VI. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e KKSB-së, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

K r y e s u e s i,
Demë Ceta